



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2020:041965

Datë: 24.03.2025

Numri i dokumentit: 07034219

C.nr. 162/2020

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA NË DEÇAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Bekim Avdimetaj, në çështjen juridike-kontesti morë të paditëses K, e S. I, me seli në P, rruga UÇK, Kompleksi Q, p.n. P, qe ka përfaqësuar me autorizim Lorik Idrizi nga Prishtina, kundër të paditurit B. M, nga fshati S, i E. K e D, baza Juridike: Rimbursim dëmi, vlera e kontestit: 754.0 € (shtatëqind e pesëdhjetë e katër euro), Gjykata pas mbajtës te seancës të shqyrtimit kryesore publike me date 19.03.2025 në prezencën e të autorizuarit të paditëses, e ne mungesë të paditurit të përpiluar me datë 24.03.2025 mur këtë :

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET në tersi kërkesëpadia e paditëses K, e S. I, me seli në P, rruga UÇK, Kompleksi Q, p.n. P, qe ka përfaqësuar me autorizim Lorik Idrizi nga Prishtina

II.DETYROHET i padituri B. M, nga fshati S, i E. K e D, që padisë K, e S. I, me seli në P, rruga UÇK, Kompleksi Qafa p.n. P, t'ia rimbursojë dëmin në shumën prej 754.00€ (shtatëqind e pesëdhjetë e katër) euro, me kamat ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes padis në gjykate me date 13.03.2020 e deri në pagesën definitivë, te gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi e nën kërcenim përmbarimit .

III.DETYROHET i padituri që padisës për shpenzimet procedurës kontesti morë te ja paguan shemën prej 20.00 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi e nën kërcenim përmbarimit .

A r s y e t i m

Paditësja ka ushtruar padi në këtë Gjykatën Themelore në Pejë, dega në Deçan, me datë 13.03.2020 me të cilën kërkon nga i padituri rimbursimin e dëmit në lartësi prej 754.0 € (shtatëqind e pesëdhjetë e katër euro).

I autorizuari i paditëses Lork Idrizi si në fillim të shqyrtimit të kësaj çështje juridiko-kontestimore ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesës se saj, duke u bazuar ne shkresat e lendes dalin faktet e treguara në padi dhe

kërkesa e saj ligjore , andaj kërkoj nga ana gjykatës që kërkesë padinë e paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Gjykata ka ftuar të paditurin me ftesë të rregullta për seancë të datës 19.03.2025 e caktuar i cili ka pranuar ftesa për seancën e dt.12.02.2025, mirëpo nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar .Andaj gjykata me kërkesën e autorizuari të paditëses ka vazhduar seancën në mungesë të paditurit në kuptim të nenit 151 ,409 par. 2 të LPK .

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje kontesti morë ka administruar provat :Raporti i Aksidentit me numër DR /////////////// 67-14 dt.14.04.2014 , Deklarata e pranimit të vlerës së shpërblimit të demit me numër 0552/01/13 me paditëses dhe N. G, shumën prej 754.00 euro e dt.27.05.2014, urdherpagesa e kompensimit të demit të N. G, në shumën prej 754 euro , urdhër transferi i pagesës se bëre nga paditësja përmes bankës BKT në xhirollogarinë rrjedhëse dt.12.06.2014.Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike - civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, pasi që:

Për gjykatën nuk ishte kontestuese se me dt. 14.04.2014 në ora 13:40 deri të aksidenti kishte ardhur si rezultat i pakujdesisë dhe mos mbajtjes se distance se duhur të automjetit "A" kishte goditur automjetin "C" i cili kishte qene para tije, ndërkohë nga rruga dytësore del një automjet tjetër "B" i siguruar tek paditësja që nga përplasia me mjetin "C" nga automjeti "A" me pasoj aksidentin komunikacioni në dëme materiale dhe me lëndime trupore. Ky konstatim është nxjerr nga raporti i policisë me numër DR 3004/01 67-14 dt.14.04.2014.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese se te dëmtuarin atëherë kishte kompensuar paditësja duke u bazuar ne Ligjin mbi sigurimin e Detyrueshëm mbi auto përgjegjesisë dhe LMD-së ka bëre kompensimin e demit material dhe jo material të palës së dëmtuar ne ketë aksident , kjo bazohet deklarata e pranimit të vlerës së shpërblimit të demit me numër 0552/01/13 me paditëses dhe N. G, shumën prej 754.00 euro e dt.27.05.2014.

Po ashtu për gjykatën nuk ishte kontestuese se pala paditëse kishte përmbushur kushtin e pagese se demit material dhe jo material ndaj palës se tret N. G, kjo vërehet nga urdhër transferi i pagesës se bere nga paditësja përmes bankës BKT në xhirollogarinë rrjedhëse dt.12.06.2014

Për gjykatën ishte kontestuese baza juridike e përgjegjesisë .

Gjykata gjeti se baza juridike e kërkesë padisë është e bazuar dhe vendosi si në pikën **I** dhe **II** , që i padituri është përgjegjëse për rimbursimit e demit paditëses gjejnë mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-018, Ligjit për Auto Përgjegjësinë nenit 14 par 1 pika 1.2 "Drejtuesi nuk ka

leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik. Përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimeve të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit; “ këtu kemi të bëjmë me humbje të mbulesës siguruese dhe njëkosishtë për drejtën e paditëses për regresi të mjeteve nga paditësit të paguara palëve të treta për zhdëmtim. Nenit 14 pika 3 i cili thotë “ Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë Rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese.”, ne këtë rast gjykata vlerëson se lind detyrimi për regres. E lidhur me dispozitën e nenit 262 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Sepse paditësja është dashur ta kompensoj dëmin të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 13.03.2020, sepse ne ditën e aksidentit padituri ka qenë i siguruar tek K-S- INSIG dhe në bazë të kontratës mbi sigurimin e auto përgjegjësisë ka bërë kompensimin e dëmit ndaj të dëmtuarve, andaj gjykata vlerëson si të bazuar .

Sipas dispozitës së nenit 7 të ligjit për procedurën kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, secila palë ndërgjyqës, ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Andaj, gjykata e vënë para një situatë të tillë dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi i të paditurit, ndaj paditëses për rimëbursimin e dëmit, në shumën prej 750.0 euro (shtatëqind e pesëdhjetë euro), e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 262 paragraf 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet të Detyrimeve. I cili shprehimisht parasheh se kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve, është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Ndërsa debitori ka për detyrë të përmbush detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi sikur është përmbajtja e tij, dhe si rezultat i kësaj paditësja ka paguar në tërësi dëmin që e ka shkaktuar i padituri. Me ç ‘rast i padituri ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësen, në të cilin raport paditësja e ka cilësinë e kreditorit kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, për arsye se i padituri ka mësuar me vonesë për detyrimin-rimbursimit e dëmit të shkaktuar nga data e vendosjes nga gjykata.

Vendimin i gjykatës si ne pikën **III** të dispozitivit të këtij aktgjykimi lidhur për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 452 par.1,e lidhur me nenin 463 par.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të paditurin e detyroi që të paguajë shpenzimet e procedurës padisë dhe atë për taksë për padi në shumën prej 20.00 euro

Nga sa u tha si me larte u vendos si ne dispozitive te këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2020:041965
Datë: 24.03.2025
Numri i dokumentit: 07034219

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA DEÇAN,
C.nr 162/2020 me dt.24.03.2025**

Gjyqtar
Bekim Avdimetaj

KËSHILLE JURDIKE

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e marrjes
nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.